



Duke u mbështetur në nenin 51 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 32 dhe 34 dhe 53 të Statutit të Komunës së Klinës, nenit 11 paragrafi 1 të Rregullores për punën e Kuvendit dhe Komiteteve të Kuvendit, nenit 9 dhe 10 të Rregullores për Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e IV-rë të rregullt për vitin 2015 të mbajtur më 29.05.2015, mori këtë:

V E N D I M

Për

Plotësimin e vendit vakant të Komitetit për Komunitete me anëtar të ri nga komuniteti ashkali, vendi i Gani Vrankaj plotësohet me Mire Ramaj

I

Behët plotësimi i vendit vakant të Komitetit për Komunitete -nga komuniteti ashkali, ku vendi i Gani Vrankaj plotësohet me Mire Ramaj nga Klina.

Ky vendim në përbërjen e vet ka të gjitha pikat e vendimit të mëparshëm të dt.23.01.2014 me 01nr.07-265/2014, përpos ndryshimit në emrin me nr.7.

Perberja e Komitetit për Komunitete si në pikën 1 të këtij vendimi ka këtë përbërje.

1. Qamile Qitaku-PDK
2. Arben Limani- LDK
- 3.Tun Dedaj- AAK
4. Vulicevic Nebojse-srpske zajednice
5. Sahit Balija -Egjiptas
6. Nexhmedin Gashi-Rom
- 7.Mire Ramaj -Ashkali dhe

Komiteti përfshin në radhët e veta shumicën e thjesht nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, anëtarët tjerë janë përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë në komunë dhe përbejnë shumicën e anëtareve të komitetit të komuniteteve (neni 53 paragrafi 1 i LVL)

II

Ky komitet punon konformë dispozitave Ligjore në fuqi: Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (neni 53 paragrafi 2), Statutit të komunës së Klinës dhe Rregullorës për punën e Kuvendit dhe Komiteteve të Kuvendit dhe Rregullores për Përbërjen dhe Kompetencat e komiteteve.

III

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Klinës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr. 06-3709 2015
Klinë më 02.06 2015



Kryesuesi,
Dr. Haxhi Ibishi